



## PROCESVERBALI

Mbledhja e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) në Rahovec, e mbajtur më **11.06.2018** me fillim në ora **10.15**. Mbledhjen e kryesoi Kryetari Komunës **Smajl Latifi**: Kuorum për mbajtjen e mbledhjes kemi.

**Kryetari**- Më lejoni ti përshëndes të gjithë të gjithë anëtarët e KKSB, Nënkryetarin e komunës, Fatmir Iska, Drejtorët e Drejtorive, zëvendës komandantin e stacionit të policisë në Rahovec z. Bekim Vuçitërna, Përfaqësuesit e organizatave, institucioneve që e përcjellin këtë takim të rregullt të KKSB-së, FSK-së, KFORIT, UNMIKUT, OSBES, përfaqësuesit e klerit fetar, përfaqësuesit e mediave dhe gjithë të pranishmit e tjerë që janë prezent në sallë. Ky është takimi i katërt për vitin 2018 i KKSB-së. Propozoj këtë rend dite:

### REND DITE

1. **Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,**
2. **Gjendja e sigurisë së përgjithshme në komunën e Rahovecit, (Konkluzat).**
3. **Diskutimi dhe aprovimi i Planit Vjetor të Veprimit të KKSB-së**
4. **Të ndryshme.**

**Kryetari** - E qes në votim rendin e ditës: Konstatoj se në mënyrë unanime është aprovuar rendi i ditës. Kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës:

#### **1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.**

Para vete e kam procesverbalin nga takimi i kaluar, këtu janë të shënuara të gjitha ato gjëra të cilat i kemi trajtuar, qëndrimet të cilat i kemi marrë nga mbledhja e kaluar.

**Sihana Duraku** – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, desha të ndërlidhem sa i përket shqetësimit që e ka ngritur në mbledhjen e kaluar z. Bujar Morina, sa i përket tregut në fshatin Ratkoc, nuk jam duke parë ndonjë përgjigje rreth kësaj pyetje, por sidoqoftë besoj se do të marrim tani në këtë mbledhje përgjigje.

**Kryetari** – Besoj se ajo që nuk është diskutuar do të diskutohet tani në këtë mbledhje. Nëse nuk ka askush diçka tjetër për të shtuar, e qes në votim Arovimin e procesverbalit nga mbledhja e kaluar: Konstatoj se në mënyrë unanime është aprovuar pika e parë (1) e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e radhës:

#### **2. Gjendja e sigurisë së përgjithshme në komunën e Rahovecit, (Konkluzat).**

Sipas asaj që ne disponojmë, si njoftimet, informacionet dhe rrethanave aq sa ne jemi të njoftuar, mundem të vije në një përfundim se në komunën tonë gjendja e përgjithshme e sigurisë vazhdon të mbetet e qetë dhe stabile, me tendencën tonë të fuqishme të përbashkët që të përmirësohet në vazhdimësi dhe të mbetet kështu siç është. Për më shumë informacione fjalën ja kalojë togerit të policisë së Kosovës z. Bekim Vuçitërna.

**Bekim Vuçitërna** – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, sot para juve do të paraqes situatën e sigurisë për periudhën dy mujore prill-maj, duke e krahasuar me vitet 2017-2018. Situata e sigurisë në zonën e përgjithësisë paraqitet e qetë dhe stabile, pa ndonjë ambicie për destabilizim për rendin dhe qetësin publike, po ashtu pa ndryshime të rëndësishme duke e krahasuar me periudhën dy mujore raportuese të vitit të kaluar. **Sa i përket rasteve penale**, gjithsej rastet të raportuara në vitin 2017 i kemi 75 raste, kurse në vitin 2018 i kemi 83 raste. Nga këto gjithsej vepra penale janë 60 me 54 raste dhe vepra jo penale 15 me 29 raste. Janë dy raste të cilat e kanë tërhequr vëmendjen e publikut, këto raste kanë ndodhur javën e kaluar, rasti i helmimin të pesë anëtarëve të familjes Morina nga fshati Ratkoc si pasojë e konsumimit të mishit të ngrirë i cili është blerë në qendrën tregtare ETC në

Rahovec, ky rast është hapur dhe janë duke u ndërmarrë të gjitha veprimet hetimore së bashku me agjensionin e ushqimit dhe veterinars AVUKUT, ku janë mare të gjitha mostrat për analiza nga ky agjensioni në fjalë. Rasti i dytë është pak i ndjeshëm pasi në varrezat e komunitetit serb në Rahovec është dëmtuar kryqi mbi një vari i varrosur rishtas hiq më larg se tre muaj, pjesa horizontale e simbolit të kryqit është shkoqur nga vendi dhe është mbështetur në shtyllën vertikale të kryqit. Vrasje në këtë periudhë në kemi pasur, lëndime të rënda trupore po ashtu nuk kemi pasur, lëndime të lehta trupore 10 raste, vjedhje 5 p raste, vjedhje të rëndë 15 raste, grabitje nuk kemi pasur asnjë rast në këtë periudhë raportuese, prishje të rendit dhe të qetësisë publike kemi pasur 1 rast, tentim për vetëvrasje nuk kemi pasur, vetëvrasje nuk kemi pasur, armbajtës pa leje 1 rast, armë të konfiskuara 1 rast, municione të konfiskuara 3 raste. Sa i përket arrestimeve sipas autorizimeve: në total janë 21 arrestime, në mbajtje policore janë 5 raste. Kurse sa i përket fletëparaqitjeve për kundërvajtje, duke e krahasuar me periudhën e vitit 2017 kemi pasur fletëparaqitje për kundërvajtje në trafik 1129 në vitin 2017, kurse në vitin 2018 për periudhën raportuese kemi pasur 1083, -4% më pak fletëparaqitje. Sa i përket aksidenteve në trafik, në këtë periudhë nuk kemi pasur aksidente me fatalitet, aksidente me lëndime 9 raste, kurse 6 me dëme materiale ku janë proceduar në trafikun rajonal në Gjakovë, kurse sa i përket stacionit policor jemi mare diku me 21 aksidente të trafikut vetëm me dëme materiale. Asistime në institucione publike kemi pasur gjithsej 6 asistencë, urdhëresa nga gjykata dhe prokuroria i kemi pasur 80 urdhëresa, kurse 70 janë realizuar. Disa nga aktivitetet operative policore, patrullime me veturë 235, patrullime në këmbë 155, pika kontrolli 391. Sa i përket projekteve të realizuara vetëdijësuese, kemi pasur një projekt Thuaj jo dhënës në familje, ligjërata të mbajtura në 7 shkolla ku janë të përfshirë 1139 nxënës. Incidente në shkolla: Me datë 08.05.2018 në ora 15:00 në shkollën fillore “12 Maji” në Ratkoc është hapur një rast me lëndim trupor, ku një person i cili nuk është nxënës në këtë shkollë e ka rrahur një nxënës të kësaj shkolle brenda në korridorin e kësaj shkolle. Kemi edhe një rast me datë 15.05.2018, në oborrin e shkollës ka qen një rast ku janë përleshur nxënësit në mes vete, rasti ka përfunduar me lëndime të lehta trupore, që të dy këto raste janë dërguar në prokurori. Sa i përket planifikimeve dhe aktiviteteve, ne tani jemi në fillim të muajit qershor, ku kemi nisur me implementimin e planit operative të sezoneve verore ku parashihen shumë aktivitete policore parandaluese, pasi gjatë muajit në vijim e sidomos gjatë muajit qershor korrik dhe gushtë ku kemi një fluks të madh të bashkatdhetarëve, të cilët vinë në pushime verore nga vendet e Evropës perëndimore dhe vendet e tjera. Zakonisht shumica nga ta vinë me vetura, duke shkaktuar një rritje të theksuar të veturave në rrugët e Kosovës, nga e kaluara kemi edhe rritje të pjesëmarrëseve në trafikun rrugor dhe si pasojë ka pasur edhe aksidente të trafikut nga të gjitha llojet. Prandaj ne si polici do të ngrisim masat e sigurisë në përgjithësi, duke bërë aktivitete të planifikuara, pastaj duke angazhuar patrullime shtesë në komunikacionin rrugor, po ashtu edhe në zonat problematike ku ka frekuentime të shumta të automjeteve dhe personave, kjo e gjitha bëhet me qëllim të luftimit dhe parandalimit të krimit në zonën e përgjithësisë në Komunën e Rahovecit. Kemi edhe disa brenga të qytetarëve të cilët kanë pasur ankesa rreth uzurpimit të hapësirës publike, e në veçanti të trotuareve në rrugët kryesore, ku shumë biznese kanë vendosur tavolina dhe kanë ekspozuar mallin në trotuare dhe kjo e pengon në masë të madhe lëvizjen e lirë të këmbësorëve. Brenga tjetër e qytetarëve por edhe e jona është mos ndriçimi i disa rrugëve dhe lagjeve të qytetit, pasi është vendosur rrjeti elektrik nëntokësor janë larguar të gjitha dritat nga shtyllat elektrike të cilët kanë qen të dedikuar për ndriçim publik, kjo shkaktonte frikë tek qytetarët dhe mundet të ndikojë negativisht rreth sigurisë së qytetarëve. Pastaj kemi ankesa nga qytetarët për një numër të madhe të qeneve endacak të cilët lëvizin në rrugët e qytetit dhe në vazhdimësi shkaktojnë frikë tek qytetarët, ku ne veçanti rrezikohen nxënësit dhe fëmijët. Pastaj kemi disa kërkesa nga disa banorë për vendosjen e pengesave në rrugë për ngadalësim të shpejtësisë, sidomos në rrugët kryesore, posaçërisht tek stacioni i autobusëve ku ka nënkallim të këmbësorëve, mendoj se është e nevojshme që të vendoset një pengesë, është një shembull i mirë vendosja e pengesës përballë Institutit të vreshtarisë dhe besoj se ka nevojë ashpër pengesa të vendosen edhe në disa rrugë të qytetit. Pastaj gjatë se zonës verore ku duhet të identifikojmë sinjalizime dhe tabela me shirita parandalues në të gjitha gropat e rrezikshme që janë hapur nga nxjerrja e zhavorrit pranë lumit të Drinit të Bardhë, po ashtu janë bukur shumë në numër edhe gropat e tjera të cilat shfrytëzohen për akumulim

të ujit për pije që janë në zonën malore. Gjatë sezonës verore shumë fëmijë i shfrytëzojnë këto gropa për freskim dhe këto gropa për dike që nuk dinë not munden të jenë edhe fatale. Kishe me qen mirë që Drejtorja e Emergjencës së bashku me Drejtorin e Inspektoratit të dalin në teren që të i identifikojnë këto gropa dhe të sinjalizohen me ndonjë shenjë ku do të tregojë se nuk janë për tu shfrytëzuar, sidomos për freskim gjatë muajve të verës.

**Kryetari** – Ju faleminderit toger, e hapim debatin rreth çështjeve që kanë të bëjnë drejtpërsëdrejti ose tërthorazi në situatën e përgjithshme të sigurisë në Komunën tonë.

**Shaip Shala – Gazetar** - Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, e përgëzoj togerin z. Bekim Vuçitërna për këtë raport të detajuar, sinqerisht më vije mirë sepse ky është takimi i tretë me radhë me këtë përbërje dhe nuk është raportuar për narkomani, shpresoj që nuk ka në komunën tonë, por megjithatë po e shtroj një pyetje togerit: sa është vigjilentë stacioni policor në Rahovec në eliminimin e kësaj dukurie.

**Bekim Vuçitërna** – Stacioni policor në Rahovec në kuadër të aktiviteteve të përditshme e ka aktivitetin Stop Droga, si në shkollë, policia e Kosovës është 24 orë në ditë e angazhuar në luftimin e kësaj dukurie. Ne në vitin 2018 kemi disa raste në komunën tonë, ku janë identifikuar dhe trajtuar si përdoruesit e drogës por edhe shpërndarësit, po ashtu sa i përket drogës është edhe njësitë i veçantë në kuadër të policisë rajonale, ata janë në çdo kohë të angazhuar në këtë drejtim dhe besoj se kanë rezultate.

**Ymret Reshiti – Përfaqësues këshillit të prindërve** – Ka një pyetje për togerin, i përmendi disa raste të rrahjes së nxënësve, një rast ishte rrahje mes nxënësve në oborr të shkollës, kurse rasti tjetër ishte në Ratkoc, mua më interesojnë informata në detale se në cilën shkollë kanë ndodhur sepse në këto raste mungon bashkëpunimi i drejtorëve të arsimit me këshillat e prindërve të shkollës dhe të komunës, neve nuk na japim informacione për disiplinën. Ne par një jave kemi dalur në vizitë nëpër shkollat e komunës sonë dhe në asnjë shkollë nuk na kanë thanë se kanë pasur ndonjë problem, çdo ku na paraqesin situatën e qetë dhe stabile. E kisha lutur drejtorin e DKA-së që të kërkoj nga drejtorët e shkollave, që ti informojnë kryetarët e këshillave të shkollave për çdo problem që ka të bëjë me disiplinën.

**Kryetari** – Së pari duhet të shtrojmë pyetjen a funksionojnë këshillat e prindërve dhe këshillat e shkollës nëpër shkollë sepse edhe ne jemi vizita nëpër shkollë, po ashtu edhe ne kërkojmë që të jenë aktive organet e shkollave, është e drejtë ajo që u kërkua nga ju sepse të gjitha shkollat duhet që ti kenë organet e shkollës funksionale, aktive dhe të përgjegjshme, në mënyrë që edhe efikasiteti i veprimeve për trajtimin më seriozë të këtyre situatave të jetë efikas.

**Fadil Sylka – Përfaqësues i bizneseve** - Përshëndetje për të gjithë, desha të ndërlihem rreth ndriçimit publik të rrugës “Mexhid Mustafa” në Rahovec, në një pjesë të rrugës janë hequr të gjitha shtyllat, pyetje ime është: A ka komuna ndonjë plan për ndriçimin e kësaj pjesa pasi kjo lagje ka qen me ndriçim publik.

**Përparim Krasniqi** – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, Do ju njoftoj zyrtarisht rreth ndriçimit publik dhe rreth investimeve që kanë ndodhur këto dy vitet e fundit. Ne që nga viti 2017 kemi trashëguar dy kontrata për ndriçim publik dhe me mjete buxhetore jemi shumë në mungesë për shkak se i kanë bërë disa kontrata shumë të mëdha dhe pastaj nuk kanë mundur të i mbulojnë mjetet, tani jemi në një situatë që nuk kemi as mirëmbajtje të ndriçimit publik dhe as nuk mundemi që ti mbulojmë ato shpenzime që kanë qen të kontraktuara në vitin 2017. Por lind pyetje se çka kemi bërë ne: Ne i kemi identifikuar të gjitha shqetësimet, janë duku 10 rrugë të pa trajtuara me ndriçim publik i kam të shënuar me emra, ne e kemi bërë projektin jemi në fazën e gjatjes së donacioneve të mundshme për mbulimin e gjitha këtyre rrugëve, ne do të shohim një mundësi përmes zyrës së kryeministrit nga zyra për komunitete, ku ju kemi adresuar me një kërkesë sepse në lagjen e epërme të Rahovecit banojnë të gjitha komunitetet dhe në këtë lagje janë disa rrugë të pandriçuara. Fatkeqësisht ne situatën e kemi jo të favorshme për shkak të mjeteve buxhetore, por jemi duke hulumtuar që të gjejmë mënyrën për ndriçim publik. Ka fundi i muajit qershor besoj se do ta kontraktojmë një kompani për mirëmbajtje të ndriçimit publik, të gjitha rrugët ekzistuese do të mirëmbahen derisa të na krijohen mundësitë për zgjerim të rrjetit të ndriçimit publik, kjo është gjendja e ndriçimit publik në Komunën e Rahovecit. Sa i

përket pengesave në rrugë, po jemi në fazën e kontraktimit të një kompanie për sinjalizim vertikal dhe horizontal, të gjitha ato kërkesa që na kanë ardhur në drejtori për pengesa në rrugë do ti shqyrtojmë me ekspertë, u do ti vendosim me standarde. Në disa rrugë janë vendosur pengesat nga banorët pa pëlqimin e komunës, të gjitha ato do të hiqen sepse kemi ankesa edhe nga banorët e atyre vendbanimeve. Ne shumë shpejtë do i ftojme edhe zyrtarët e policisë së Kosovës, ku do të kërkojmë nga ta që të na identifikojnë ata ndonjë rast që ne nuk e dimë, pastaj të na tregojnë se ku janë rrugët e ngushta ku ka nevojë që të vendosen pasqyrat tredimensionale.

**Lulzim Krasniqi – Përfaqësues i OJQ-ve** – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, desha të diskutoj rreth trotuareve tek Rruga e UÇK-së dhe rreth rrotullimi tek rasat e Rahovecit, kjo paraqet problem për sigurinë në trafik sepse qytetarët obligohen që të kalojnë nga një trotuar në tjetrin kurse në atë rrugë makinat lëvizin me një shpejtësi të madhe. Pastaj shqetësimi tjetër ka të bëjë me semaforët, ata janë ndriçues por më duket se diçka nuk është në rregull me ta në sistemin e punës.

**Përparim Krasniqi** – Sa i përket trotuareve ne duhet të shikojmë që në të ardhmen të bëjmë një planifikim, komuna tanë është në fazën e dëgjimeve publike dhe duhet që të mendohet që në të ardhmen të vendoset një trotuar sepse është një kosto goxha e lartë, ne fatmirësisht e kemi fituar një projekt në 2017 nga DEMOSI për rregullimin e trotuareve në anën e djathtë të rrugës. Kurse për projektin tjetër duhet që të shikohen mundësit buxhetore në vitin e ardhshëm që të bëhet një planifikim, po ashtu ky planifikim duhet që të bëhet në faza për arsye se komuna nuk ka mundësi që ti mbulojë të gjitha projektet. Po ashtu në rrugën e UÇK-së janë edhe disa pengesa nëntokësore, ka kanalizime të vjetra të cilat nuk anë të vendosura me standarde, prandaj duhet që të shikohet mundësia që të rregullohet pjesa nëntokësore e pastaj të rregullohen trotuaret. Sa i përket semaforëve është e vërtet se ka disa telashe, kemi ndërhyrë dy tre herë por këto semaforë janë të vjetër do të shikojmë në të ardhmen që të bëjmë diçka.

**Kryetari** – Do i përgjigjem shqetësimeve që u ngritën aq sa kam mundur që ti shënoj, së pari falënderoj togerin e policisë së Kosovës z. Bekim Vuçitërna për informatat e vlefshme që na i dha. Mendoj se tani është momenti që policia e Kosovës të tregoj më shumë efikasitet, më shumë kontrolle sepse jemi duke hyrë në sezonën e verës dhe parashihet që të kemi më shumë trafik, kjo duhet që të jetë prioritet edhe i gjithë neve së bashku jo vetëm i policisë së Kosovës, në mënyrë që të përballohet në mënyrë sa më të mirë situata nga fluksi i mërgimtarëve. Prandaj si konkluzë kërkoj nga policia e Kosovës që të ketë më shumë asistencë të zyrtaeve komunal në mënyrë që të përmbushen sa më mirë detyrat pa një sinjale frike nga zyrtarët komunal, është e natyrshme që të kemi elemente negative të cilat kërcënojnë njerëzit në detyrë, kjo mundet të ndodhë kryesisht inspektoratit për arsye të natyrës së punës që ata e kanë. Uzurpimi i hapësirave publike është një çështje që trajtohet vazhdimësi dhe ne duhet që të jemi më seriozë në lirimimin e trotuareve, e kam thënë edhe më parë që është mirë që të bëhet një fushatë sensibilizuese, po ashtu policia ta kryej punën e vetë, automjetet nuk është mirë që të bëjnë natën në trotuare në rrugën kryesore, kam parë shumë makina që flenë në rrugën kryesore, ne nuk e kemi qëllimin që të gjobisim dike por ne nuk mundemi të heqim dorë nga kërkesa permanente që të hiqen makinat dhe të lirohen trotuaret. E di që kemi probleme me parkingje, por e di që kudo në botë nuk ngurojnë njerëzit që ti parkojnë ne auto parkingje, tek ne njerëzit kanë parkingje pa pagesë por ngurojnë që zi parkojnë sepse mundohen që aty ku janë ata të jenë edhe makinat, prandaj kërkoj nga policia e Kosovës që të jetë shumë më efikase dhe shumë më serioze në lirimimin e hapësirave publike sepse kudo që shkojmë edhe si kryetar komuna na japin vërejtje dhe kjo është e natyrshme sepse këto problem duhet që të zgjidhen. Ne nuk jemi kundër asaj që nëse dikush ka të kryej një shërbim për 5 minuta të ndalohet të parkoj, por nëse dikush mendon se duhet që të parkoj makinën në trotuar me orë dhe ditë të tëra e ka gabim, sepse ne nëse përballemi me ndonjë pasojë e gjithë përgjegjësia në kryetarin e komunës dhe institucionet përgjegjëse. Pastaj e kam vërejtur se përskaaj rrugës kryesore ka hekurishte, unë i ftoj drejtorit përkatëse që të merren masat që ato pamje dhe ato kërcënime për sigurinë që i kemi sot jo vetëm që e shëmtojnë qytetin, por edhe paraqesin rrezik për qytetarët, ka standarde se si duhet të funksionojnë këto hekurishte. Prandaj si konkluzion e marrim që shumë shpejtë të mirën modalitetet dhe të paralajmërohen që situata të tilla nuk do të lejohen në komunën tonë. Sa i përket ndriçimit publik është e vërtet ajo që e tha z. Përparim Krasniqi, ne i kemi prioritetet

tona si në fshatra ashtu në qytetet që të ketë zgjerim të ndriçimit publik. Sa i takon planit për luftimin e narkotikëve kjo natyrisht është detyrë e policisë së Kosovës dhe ne mendojmë se vazhdimi i fushatave senzibilizuese është një detyrë e policisë së Kosovës dhe drejtorisë së DKA-së, nuk jam në dijeni a ka apo nuk ka, por nëse ka dikush informata mendoj që kishte me qen mirë që të jeni bashkëpunues me policinë për ti dhënë informata. Në fund besoj se ne kemi edhe prishje të qetësisë publike me motoçikleta, prandaj e lusë policin e Kosovës që të shikohet se a kanë ata patenta apo a duhet që ata pas orës 2 pasmesnate të dalin në qytet dhe të bëjnë zhurma. Po ashtu ne në këtë takim kuadër të kësaj pika parashohim që është me rëndësi të futet në listën e prioritetëve që të shihet se kush janë këtë lëmsh kërkuesit, sepse nëse shkohet në një kauteri vinë lëmsh kërkuesit dhe ne nuk e dimë se nga janë këta, prandaj është mirë që policia e Kosovës të i bëjë identifikimin e tyre. Besoj se policia e Kosovës e ka planin operativ për pritjen ose menaxhimin e situatave të reja që krijohen me ardhjen e mërgimtarëve tonë, është një lajm tepër i mirë kur vinë mërgimtarëve në vendin e vetë, ata na sjellin shumë të mira neve, por policia besoj se e ka një plan. Siguria në trafik, gjendja e sigurisë në shkollë, monitorimi mbi nivelin e sigurisë në shkollë, vjedhjet në territorin e Komunës sonë, natyrisht se këto janë sfidë për të gjithë ne e posaçërisht për policinë dhe DKA-në. Edhe një herë ju falënderoj të gjithëve për kontributin që jeni duke e dhënë dhe shpresoj se do të jepni në vazhdimësi për sigurinë e përgjithshme në Komunën e Rahovecit, në mënyrë që ajo të jetë stabile dhe e qëndrueshme dhe sa më pak delikuecë, shpresojmë se përballet tona me të keqen kanë me qen shumë më efikase dhe rezultatet nuk do të na mungojnë as në muajin e mërgimtarëve, por edhe siguria e përgjithshme të shtohet me komponentë të tjera të sigurisë afatgjate. Nëse nuk ka askush të shtojë edhe diçka sa i përket kësaj pike, kalojmë në pikën e radhës:

### **3. Diskutimi dhe aprovimi i Planit Vjetor të Veprimt të KKS-së.**

Para vete e keni Planin Vjetor të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, natyrisht se ky plan mundet të ndryshohet nëse propozohet diçka nga ju, ky plan mars – dhjetor 2018 përmban elementet kryesore bazike ose shtyllat kryesore se ku duhet të kemi ne fokusin. Nëse ka dikush të shtoj diçka rreth këtij plani atëherë fjala është për ju.

**Bekim Vuçitërna** – Pasi është diskutuar për parkingje ilegale nëpër trotuare, ne në mbledhjen e kaluar e kemi bërë një kërkesë për funksionalizimin ose auto bartjes ose merimangës, desha të informohem a është bërë diçka në këtë drejtim.

**Përparim Krasniqi** – Sa i përket auto bartjes ne qysh në fillim të mandatit jemi interesuar për këtë çështje, ne tani jemi duke e punuar Draft rregulloren e brendshme për auto bartje, në momenti që do të jetë gati draft rregullorja ne do e qesim edhe në debat publik sepse është kusht ligjor. Pasi të përfundoj e gjithë kjo procedurë ne do e qesim në ankand publik dhe ata ofertuesit të cilët vinë duhet që ti plotësojnë disa kushte. Sa i përket qenve endacak për herë të parë AVUKU ka kontraktuar kompanitë për trajtimin, eliminimin e qeneve endacak, dy komani janë për regjionin e Gjakovës, në momentin që i kontraktojnë ata neve do të na vije një informatë dhe të gjitha institucionet komunale do të njoftohen zyrtarisht për formën e trajtimit.

**Kryetari** – Deri sa të bëhet rregullorja është një kohë që duhet të gjendet zgjidhje, prandaj kërkoj nga ana e policisë që të i lirojë trotuaret, pa pasur nevojë për konfrontime, kemi disa pika ku mundemi që ti drejtojmë qytetarët që ti parkojnë makinat. Nëse jo ne do të përballemi si me moral publik, personal dhe politik, nuk kisha dashur që të mare përgjegjësi nëse ndodhë diçka e keqe, që uroj që mos të ndodhë kur. Mbrojtja e trotuarit nga uzurpimi është detyra e jona dhe e juaja dhe është mirë që të krijohet klima që janë duke u liruar trotuaret. Por nëse dikush tenton të i rezistoj ligjit atëherë është shumë më mirë që ai të dënohet në mënyrë që mos të pasojë dikush tjetër. I kthehem diskutimit rreth pikës së dytë.

**Nysret Abazibra** – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, po e shohë se në këtë plan qenka e paraparë edhe pika e parandalimit të lëmsh kërkuesve, desha edhe unë ta e ngris një shqetësim si bashkësi fetare sepse edhe ne jemi duke u ballafaquar me këtë problem dhe lirishtë mundem të them se kemi dy lloje të lëmsh kërkuesve, lëmsh kërkuesit të cilët janë vendas dhe i njohim se kush janë dhe çdo herë pothuajse në kohën e faljes së namazit janë tek xhamitë tona. Prandaj kisha kërkuar nga organet kompetente që të bashkëpunojmë, zakonisht janë fëmijë por me të vërtet janë duke na

shqetësuar gjatë faljes, kishte me qen mirë që të mirët ndonjë masë ndaj prindërve të tyre sepse fëmijëve nuk kemi se çka të i bëjmë. Pastaj kemi lëmshoh kërkues që nuk i njohim se kush janë, ne si bashkësi fetare kemi marr një qëndrim dhe nuk kërkujmë në xhemat ndihmë nëse nuk na sjellë ndonjë dëshmi nga organi ynë më i lartë e që në këtë rast është Bashkësia Islame e Kosovës, kurse për njerëz që ne i njohim diskutojmë dhe marrim një vendim pastaj, siç ishte edhe rasti i fundit në xhumanë e kaluar për z. Mizahir Haxhijaha, ku kemi kërkuar ndihmë për shërim. Kishte me qenë mirë që të gjendet një bashkëpunim i cili do të na ndihmonte edhe neve shumë dhe kur të marrim aksion të jetë aksion i qëlluar dhe me vend, besoni se në çdo ditë premte kemi shumë kërkesa saqë shumë herë edhe ne po ngushtohemi sepse ndoshta janë raste që me të vërtet kanë arsye, por ne nuk jemi organ që mundemi që ti ndihmojmë të tjerët.

**Kryetari** – Me të vërtet është shqetësim e sidomos në ditët e veçanta siç është dita e xhumasë, pastaj në muajin ramazan, në bajram dhe shumë festa të tjera që i kemi. Nuk e di se nga vinë por mirë kishte me qen që të kihet një koordinim edhe me qendrën për punë sociale që të jetë në kontakt me drejtorin e shëndetësisë dhe me inspektoratin, pastaj edhe policia në[ mënyrë që të kemi situatën e menaxhueshme. Por siç po shihet dikush është duke i lëshuar ata në rrugë në mëngjes dhe në mbrëmje dikush ja merë atë pazarin ditor. Por sidoqoftë është një shqetësim dhe adresim serioz, ne këtë shqetësim do ta kemi parasysh.

**Bekim Vuçitërna** – sa i përket dukurisë së lëmshoh kërkimit me të vërtet është shqetësuese, policia në bazë të kompetencave që i ka i trajton këto raste pasi kjo dukuri është e sanksionuar edhe me ligjin për prishje të rendit dhe të qetësisë publike. Kemi projekt të vazhdueshme për luftimin e lëmshoh kërkimit, kemi pasur raste që i kemi zanë deri në 150.00 € vetëm për një paradite, ato raste i dërgojmë në gjykatë dhe gjykata i trajton këto raste. Në të shumtën e rasteve vinë në mënyrë të organizuar nga Shqipëria duke i simuluar defektet trupore në mënyrë që të shtynë në gjynah që thonë dhe ti të i japësh pare. Ne si polici kërkujmë ndihmë nga qendra për punë sociale pasi që kemi shumë raste nga lagja e epërme e qytetit që rinë rrugës dhe kërkujmë, ne shumë herë ju kemi tërhequr vërejtje prindërve të tyre por ata janë duke vazhduar. Policia e Kosovës është e gatshme çdo herë që ti ofroj ndihmë qendrës për punë sociale nëse dëshirojnë që të bëjnë një projekt të përbashkët për luftimin e kësaj dukurie.

**Kryetari** – Besoj se Qendra për punë sociale, drejtoria e inspektoratit, KLSP-ja dhe Policia e Kosovës do të gjejnë një modalitet që ta luftojnë këtë dukuri që së paku të dimë se ku jemi. Por besoj se duhet një veprim edhe në nivel shteti sepse kjo situatë është në çdo qytet të Kosovës.

**Nysret Abazibra** - Desha ta ngris edhe një shqetësim që zakonisht ndodhë në fshatra në ditët e xhumasë, në formë të organizuar vjen një vaze me një djalë me disa kërkesa me do foto ku kërkujmë ndihmë, por ata vinë siç e thashë në formë të organizuar. Para dy jave e kemi pas një rast në fshati Apterushë, ku na erdhën pa kurrfarë dokumenti nga pushteti lokal, prandaj edhe për këtë çështje nëse na kërkohet një raporte për të dërguar organeve kompetente ne do të bëjmë.

**Bekim Vuçitërna** – E tash edhe më parë se policia i ndërmerr të gjitha veprimet sipas ligjit dhe kompetencave që i ka, ne nuk mundemi që ti arrestojmë fëmijët sepse janë të papërgjegjshëm penalisht, kurse qendra për punë sociale duhet që të bisedoj me ata fëmijë dhe me prindërit e tyre. Sa i përket asaj që e tha hoxha që vinë nëpër xhami në formë të organizuar, ata persona nuk janë nga fshatrat tanë, kjo dukuri është shumë profitabile dhe prandaj këta vinë nga qytetet e tjera të Kosovës si Ferizaj, Kaçaniku dhe etj. Por nuk janë nga Komuna jonë, ata i marrin disa fatura disa dokumente kishe një person është shumë i sëmurë, por kjo është mashtrim. Kur të keni kesi raste është mirë që të njoftohet policia e Kosovës sepse ky është edhe një krim i organizuar dhe mbrapa tyre qëndron një shef ose bos i cili ose i detyron të kërkujnë ose i paguan mëditje.

**Kryetari** – Pajtohem që këta e shfrytëzojnë këtë situata por edhe ne jemi pak fajtorë që i japim pare, ata ose i shfrytëzon dikush ose janë mësuar që të kërkujnë lëmshohë. Për fat të keq ne kemi këso raste edhe në Komunë, ku na vinë për ndihmë momentale ne i japim një herë ata vinë pas një muaji prapë, kur ti shikosh gjoksin sa dera që e thonë populli dhe është mirë që të i grahja punës dhe të punojë sepse ne një herë i ndihmojmë por më nuk mundemi edhe nëse dëshirojmë nuk kemi të drejtë ligjore që ti ndihmojmë të njëjtit person dy herë.

Me këto vërejtje dhe synime që të plotësohet në vazhdim ky plan, e qes në aprovim: Konstatohet se në mënyrë unanime është aprovuar Planit Vjetor i Veprimit i KKS-së. Kalojmë në pikën e fundit:

#### 4. Të ndryshme.

**Fadil Sylka** – I nderuari kryetar kam disa shqetësime rreth punëtorëve të komunës për disa dukuri që i kam vërejtje personalisht, po ashtu desha ta di a ka ndodhë në këtë muaj ndërprerje të rrymës në komunë dhe nëse po atëherë mendoj se personi përgjegjës është dashur që të kujdeset që mos të ketë ndërprerje të rrymës në objektin e komunës. Pastaj tek administrata e komunës nuk ka pasur rrjetë disa ditë, mendoj se punonjësit e administratës kanë mundur që ti marrin shënimet palës dhe pasi të vije rrjeti të ja nxjerrin certifikatën ose ndonjë dokument tjetër, sepse shumë palë e kanë lënë punën për të nxjerrë një dokument dhe ai nuk mundet të rinë në objektet e komunës, e jo sillen keq me palët dhe ti thonë shko ankohu tek kryetari, ne e dimë që kryetari nuk mundet për çdo gjë të jetë i informuar.

**Kryetari** – Kjo ka ndodhur si pasojë e veprimit të KEDSIT gjatë heqjes së kabllave dhe shtyllave, duke i futur në tokë kabllot e kanë këputur një fije e kabullit që është i PTK-së, por PTK-ja 3 muaj më parë ka qenë e njoftuar, por mos efikasiteti i PTK-së dhe pakujdesi i KEDSIT e ka sjellë atë që ti je duke e thënë. Paramendoni 3 ditë Komuna, Policia dhe Gjykata kanë qenë pa rrjetë dhe pa shërbime, unë vetëm sa nuk i kam shpallur luftë, ku i kam thirrë Ministrin e Brendshëm, drejtorin e PTK-së dhe kam kërkuar që kjo punë të rregullohet sa ma shpejtë. Më vije shumë keq që palët vinin dhe nuk mundeshin të kryenin shërbime, por paramendoni nëse nuk e kishim bërë në presion direkt, e kem reagimin shumë të fortë dhe mare ndonjë herr përgjegjësi që nuk më takojnë, nuk kishin pas ndërmend që të rregullojnë. Paramendoni vinin nga Prishtina dhe sillëshin vërdallë dhe thoshin se nuk mundemi me e rregullu, prandaj si komuna ashtu edhe institucionet e tjera duhet që të lirohen nga këta zyrtarë të papërgjegjshëm, për fate të mirë kjo situata është tejkaluar dhe tani çdo gjë është në rregull edhe pse më së shumti komuna ka humbur sepse ka pas palë që ka ardhur nga Zvicra ta paguaj tatimin. Sa i përket atyre zyrtarëve komunal që nuk sillen mirë me palë, qëllimi ynë nuk është që ta ndëshkojmë dikë, por rendin, disiplinën dhe detyrën ka me e krye sipas ligjit. Prandaj ju motivojmë që të na sillni video ose foto neve dhe ne ja përkujtojmë detyrat e punës nëse ai ose ajo i ka harruar. Besoj se situatat e tilla nuk do të na ndodhin më ose të i marrim masat me kohë.

**Ymret Reshiti** – I nderuari Kryetar desha t'i përgjigjem në pyetje z. Fadil Sylka pasi jam edhe punëtor i administratës, programi i intranetit nuk lejon kopje fizike ose kërkesë të bëhet më në gjendjen civile, pra nëse nuk ka rrjetë nuk ka shans asnjë kopje fizike të bëhet, nëse nuk bëhet kërkesa në program nuk mundet as arkëtari ta bëjë pagesën.

**Kryetari** – I marrë përgjegjësit ashtu siç e kam edhe të drejtën, kryetari ka përgjegjësi nëse bie sistemi dhe askush nuk e ka bërë me qëllim këtë punë, por prapë e them se për këtë duhet të ketë përgjegjësi, ani pse nuk lëshoj unë certifikatën por duhet të shikohet se çfarë veprime ka ndërmarrë kryetari në situatën tilla. Ky gabim ka mundur të evitohet, prandaj ma mirë është që asi zyrtarë të rinë në shtëpi dhe jam i gatshëm të ja paguaj rrogën vetëm që mos me bë ndonjë gabim të tillë. Është e vërtetë ajo që e tha z. Ymret Reshiti, por detyra e zyrtarëve tanë është që të sillen mirë me palë, nëse nuk mundesh me ja krye shërbimin atëherë duhesh të i tregosh palës arsyen pse në mënyrë shumë të qetë. Sjellja e mirë e zyrtarëve duhet që të reflektoj një imazh të mirë për të gjitha komunat e Kosovës.

**Shqip Shala** – Z. Kryetar i nderuar do të ishte vepër shumë e mirë, humane dhe fisnike nëse Drejtoria për buxhet dhe financa së paku një mëditje nga mbledhjet e mbajtura të në paguaj.

**Ramë Berisha** – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, edhe në takimet e kaluar i kam shprehur disa nevoja dhe disa kërkesa, kam kërkuar nga inspektorati një urdhëresa për një pus të një komshiu që unë nuk mundem të merrem vesh me të. Pastaj kam kërkuar edhe vendosjen e anësorëve të një ure në fshatin Xërxë sepse nëse kjo nuk vendoset rrezikon jetën e qytetarëve. Pastaj është një rrugë diku 150 m e cila duhet që të shtrohet me asfalte sepse në kohë dimri kjo rrugë është vështirë e kalueshme.

**Kryetari** – Shumë mirë që ma përkujtove i nderuar, sapo të përfundoj mbledhje do të bisedoj me drejtorin e financave që kjo kërkesë të realizohet. Urime festa e Fitar Bajramit të gjithëve e posaçërisht atyre që ja kanë bërë hyzmetin më shumë, uroj që në familjet tona të ketë sa ma shumë gëzime dhe sofrat tona të jenë sa më të begatshme, pastaj të ketë sa më shumë punë, dinjitet dhe sa më pak

probleme. Besoj se drejtori i inspektoratit dhe i drejtorit i shërbimeve publike i kanë dëgjuar hallet dhe kërkesat e z. Ramë Berishës, kisha pas dëshirë që këto kërkesa të mos përsëriten dhe ne të i kryejmë punët tonë, ne duhet që të shikojmë se a ka mundësi që të kryhen sa më shpejtë këto punë, a janë të planifikuara diku apo jo, por besoj se shumë shpejtë do të kryhet kjo punë.


Ju falënderoj edhe një herë për kontributin e dhënë në këtë takim, e deklaroj të mbyllur këtë takim shihemi në takimin e radhës.

**Mbledhja përfundoi në orën 11:20**

Procesmbajtësi



Skender Hamza



Kryetari i Komunës



Smajl Latifi